URDHËR
Nr. 106, datë 1.8.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; si dhe të VKM-së nr. 395, datë 13.5.2020, "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të Negocimit dhe Asistencës Ligjore, znj. Denada Dosti.
2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin do të ushtrohen për periudhën nga data 10.8.2023 deri më datë 16.8.2023.
3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Denada Dosti.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahimi